


Lënda: Përcjellim kriteret e pranimit në Ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike dhe Master Profesional në Inxhinieri Informatike për vitin akademik 2022-2023.

Kriteret e pranimit në Ciklin e Dytë të studimeve për vitin akademik 2022-2023.

1. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike:

- Në Programin e Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike, mund të pranohen vetëm personat që zotërojnë:
 - I.** Diplomë të nivelit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike ose Inxhinieri Telekomunikacioni , Inxhinieri Elektronike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjajshme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga Departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MAS, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioritetëve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambientet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;
 - II.** Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.
- Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:
 - 1.** Renditen fillimisht, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet te jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).



2. Renditen të dytët në vijim të pikës 1, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë ≥ 7.00 .

3. Renditen të tretët në vijim të pikës së 2-të të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor ose ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Informatike të fituar në UPT ose jashtë saj, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).

2. Programi i studimit **Master Profesional në Inxhinieri Informatike:**

➤ Në Programin e Studimit Master Profesional në Inxhinieri Informatike, mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

I. Diplomë të Ciklit të Parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisionet ad hoc që ngrihen nga departamenti;

➤ Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT.

2. Nqs, pas pranimet të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët e FTI që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni.

3. Nqs, pas plotësimit të pikës 2, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar në UPT të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

4. Nqs, edhe pas plotësimit të pikës 3, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar jashtë UPT, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,